Pa. nr. 08-127

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar lidhur me njoftimin për përqendrim të parashtruar nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb**,** me seli në rr. Koturashka Cesta nr. 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, nëpërmjet avokates Maja Pargovska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 23.09.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. KoturaSHka Cesta nr. 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, do të fitojë kontrollin mbi PROFESSIONAL SUPPORT s.r.o., me seli në Vorishkova 402/11, Kohoutovice, 623 00 Brno, Republika Çeke, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve në treg, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim që të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumën prej 6.000 denarësh dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000 denarësh, sipas tarifës nr. 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), më datë 26.03.2026, ndërsa e plotësuar më datë 01.09.2026 dhe 03.09.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta nr. 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb do të fitojë kontrollin e vetëm të drejtpërdrejtë mbi PROFESSIONAL SUPPORT s.r.o., me seli në Vorishkova 402/11, Kohoutovice, 623 00 Brno, Republika Çeke, nëpërmjet shitblerjesë së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për Përqendrim, plotësimit të tij dhe shtojcave përkatëse, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Objekt i veprimtarisë së ORBIKO SHPK për tregti Zagreb është tregtia me shumicë, ndërsa e njëjta është gjithashtu përfaqësuese dhe distributore në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh brendesh, të cilat përfshijnë produkte për kujdesin dhe bukurinë, produkte ushqimore dhe joushqimore, pajisje teknike dhe elektrike, barna, lodra, tekstile, cigare, vajra motorikë, produkte kimike për amvisëri dhe shumë produkte të tjera. Partnerët më të mëdhenj të ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, produktet e të cilëve përbëjnë pjesën më të madhe të qarkullimit të ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, janë PHILIP MORRIS INTERNATIONAL, PROCTER & GAMBLE, SHELL dhe S.C. JOHNSON ITALY S.r.l.

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet shoqërisë së tij të varur, Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime ORBIKO SHPK Shkup, me seli në rr. „Boris Trajkovski“ nr. 286, Komuna e Kisella Vodës, 1000 Shkup. Objekti kryesor i veprimtarisë së ORBIKO SHPK Shkup është tregtia me shumicë e paspecializuar. E njëjta është përfaqësuese dhe distributore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh brendesh të produkteve ushqimore, vajrave motorikë, baterive, parfumeve, ujërave të tualetit dhe deodorantëve, kozmetikës dekorative, produkteve për higjienë personale, produkteve për kujdes dhe produkteve për mirëmbajtjen e higjienës në amvisëri.

Objekt i veprimtarisë së PROFESSIONAL SUPPORT s.r.o. është tregtia me shumicë dhe pakicë e produkteve profesionale për pastrim (produkte kimike industriale dhe teknike).

Me transaksionin e propozuar, ORBIKO SHPK për tregti Zagreb fiton kontroll të drejtpërdrejtë mbi PROFESSIONAL SUPPORT s.r.o., dhe në këtë mënyrë edhe kontroll të tërthortë mbi shoqëritë e saj të varura, si vijon:

(1) PROFESSIONAL SUPPORT s.r.o., me seli në Sv. Štefana nr. 5, Štúrovo, Sllovaki, objekt i veprimtarisë – tregtia me shumicë dhe pakicë e produkteve profesionale për pastrim (produkte kimike industriale dhe teknike); dhe

(2) PROFESSIONAL SUPPORT Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me seli në rr. Arok nr. 3, 2500 Esztergom, Hungari, objekt i veprimtarisë – tregtia me shumicë dhe pakicë e produkteve profesionale për pastrim (produkte kimike industriale dhe teknike).

Përveç shoqërive të varura të përmendura këtu, PROFESSIONAL SUPPORT s.r.o. nuk ka shoqëri të tjera të varura, nuk është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa shoqëritë e tij të varura të përmendura më sipër nuk kanë shoqëri të tjera të varura, nuk janë të pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizojnë të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i përmbush kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe të nenit 14 paragrafi (1), pikat 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se

përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1), pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ